

VENDIM
Nr. 387, datë 10.7.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 322, DATË 11.6.2025, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË NEGOCIMIT TË
SHOQËRISË SHTETËRORE ‘KAYO’ SHA, ME SHOQËRI TREGTARE PRIVATE
PËR PRODHIMIN OSE PËRSHTATJEN E MJETEVE MOTORIKE TË POSAÇME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr. 322, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të negocimit të shoqërisë shtetërore ‘KAYO’ sh.a., me shoqëri tregtare private për prodhimin ose përshtatjen e mjeteve motorike të posaçme”, numri 45 zëvendësohet me numrin 20.

2. Ngarkohet shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku